



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 1830/1 Prot.

Tiranë, më 02 /11/ 2019

**V E N D I M**

**Nr. 176 , Datë 02 / 11 / 2019**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr.57 Regj., datë 28.05.2019, të F. B, kundër Spitalit Universitar të Traumës (SUT), me pretendimin e diskriminimit për shkak të “*përkatësisë në një grup të veçantë<sup>1</sup>*”, si dhe “*çdo shkak tjetër<sup>2</sup>*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>3</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Subjekti ankues, F. B ka lidhur marrëdhëniet e punës me Autoritetin Shëndetësor Rajonal Tiranë (ARSH), me datë 28.05.2011<sup>4</sup> në detyrën e Infermierit të Urgjencës. Kontrata individuale e punës është nënshkruar për një afat të pacaktuar kohor.

Ndërkaq, në vazhdim të kontratës të punës lidhur me ARSH-në, Urdhërit të Ministrit të Shëndetësisë me nr.38 prot., datë 01.02.2016 “Për transferimin e personelit të Shërbimit të Urgjencës Mjekësore Tiranë”, me datë 01.01.2017 është lidhur kontrata individuale e punës për një afat të pa caktuar kohor, mes subjektit ankues në cilësinë e punëmarrësit dhe Spitalit

<sup>1</sup> Referuar shkresës me nr.extra prot., datë 10.05.2019 të Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë, F. B është zv/president i kësaj shoqate.

<sup>2</sup> Subjekti ankues referohet tek ky shkak duke nënkuptuar denoncimet e bëra prej tij publike/mediatike kundër të metave të sistemit aktual të shëndetësisë.

<sup>3</sup>Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

<sup>4</sup> Referuar Kontratës Individuale të Punës.

Adresa: Rruga e Durrësit, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al), web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

Universitar të Traumës (SUT) në cilësinë e punëdhënësit. F. B është emëruar Infermier në Shërbimin e Urgjencës Ambulatore në SUT,

Subjekti ankues është shprehur se nga data 8 Shkurt 2017 e në vijim është përfshirë në denoncime publike dhe mediatike, lidhur me realitetin dhe gjendjen e Urgjencës së Tiranës dhe asaj Kombëtare. Ankuesi shprehet se që pas këtij momenti ai është diskriminuar vazhdimisht duke u ndjerë nën presion, gjë e cila ka vijuar me transferimin e tij në një pozicion tjetër pune, duke ndikuar në ndryshimin e vendit të punës, pagës së tij dhe elementëve të tjerë të kontratës individuale të punës.

Referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës, rezulton se nëpërmjet shkresës me nr.426 prot., datë 08.02.2019, “Vendim për komandim në detyrë personel infermieror në SUT”, subjekti ankues me detyrë Infermier në Shërbimin e Urgjencës Ambulatore në SUT, për nevoja pune dhe shërbimi, është komanduar të punojë Infermier Shërbimi i Kirurgjisë 2, në Shërbimin e Konsultave të Specializuara Ambulatore në SUT, nga data 08.02.2019 deri në një urdhër të dytë.

Nëpërmjet shkresës me nr.939 prot., datë 06.05.2019 të Shërbimit të Konsultave të Specializuara Ambulatore në SUT, rezulton se subjekti ankues:

- Nga data 11.02.2019-17.02.2019 ka qenë me raport mjekësor.
- Nga data 18.02.2019 deri me datë 17.03.2019 ka marrë lejen e zakonshme dhe nga data 18.03.2019 deri me datë 18.04.2019 për arsye familjare ka marrë leje pa të drejtë page.
- Nga data 18.04.2019 ka refuzuar të punojë pranë këtij Shërbimi, fakt për të cilin ka vënë në dijeni paraprakisht Burimet Njerëzore. (Shkresa me nr.02-F prot., datë 20.03.2019)

Nëpërmjet shkresës me nr.1264 prot., datë 10.05.2019 “Urdhër për ndërprerje të marrëdhënieve financiare dhe kontakt të punë personeli infermier në SUT”, SUT në cilësinë e punëdhënësit ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me subjektin ankues.

Subjekti ankues parashtron se e ka kundërshtuar shkresërisht transferimin e tij dhe prandaj ka refuzuar ta pranojë atë. Ai shprehet se nuk i është kthyer përgjigje shkresore lidhur me arsyet e transferimit të tij, por e gjithë procedura e iniciuar ndaj tij ka qenë tendencioze dhe diskriminuese.

Ankuesi shprehet se gjatë 30 viteve të tij të punës nuk ka marrë asnjë vërejtje lidhur me kryerjen e detyrës së tij si infermier, ndërsa i janë dhënë qëllimisht dy masa disiplinore brenda më pak se dy muajve, me qëllimin për të ushtruar presion ndaj tij. Ai ka cituar shkresën me nr.3471 prot., datë 13.11.2018, nëpërmjet të cilës i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje” dhe shkresën me nr.2782 prot., datë 20.12.2018, nëpërmjet të cilës i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna”. F. B ka cituar se i ka kundërshtuar shkresërisht këto masa por nuk janë marrë në konsideratë nga ana e punëdhënësit.

Në përfundim, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatimin e diskriminimit të tij për shkak të denoncimeve mediatike, në cilësinë e z/v presidentit të Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë, nga ana e punëdhënësit dhe rikthimin në vendin e punës.

## II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së<sup>5</sup>, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

**Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.**

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankesë, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës me nr.814/1 prot., datë 07.06.2019 nga ana e KMD i është kërkuar informacion dhe dokumentacion provues SUT-së, lidhur me pretendimin e ankuesit<sup>6</sup>.

<sup>5</sup>Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

- <sup>6</sup> Argumentimi i SUT lidhur me pretendimet e subjektit ankues për diskriminim lidhur me shkaqet e pretenduara prej tij.
- Kopje e dosjes personale të .F. B (Emërime, kontrata pune, masa disiplinore, Librezë Pune, etj)
- Kopje e procedurës së ndjekur lidhur me komandimin/transferimin e F. B.
- Informacion dhe parashtrime lidhur me nevojat e lindura për komandimin e ankuesit në Shërbimin e Konsultave të Specializuara Ambulatore në SUT.
- A janë bërë komandime të tjera të njëjta apo të ngjashme me ankuesin, të personelit infermieror? Nëse po, kopje të procedurës së ndjekur rast pas rasti, duke specifikuar dhe arsyen e komandimit.
- Informacion dhe dokumentacion provues lidhur me trajtimin financiar (pagën) e ankuesit në pozicionin e mëparshëm si Infermier në Shërbimin e Urgjencës Ambulatore në SUT (para komandimit).
- Informacion dhe dokumentacion provues lidhur me trajtimin financiar (pagën) e ankuesit në pozicionin si Infermier Shërbimi i Kirurgjisë 2, në Shërbimin e Konsultave të Specializuara Ambulatore në SUT (pas komandimit).
- Kriteret, specializimet e kërkuara për pozicionin e punës si Infermier Shërbimi i Kirurgjisë 2, në Shërbimin e Konsultave të Specializuara Ambulatore në SUT.
- Kriteret, specializimet e kërkuara për pozicionin e punës si Infermier në Shërbimin e Urgjencës Ambulatore në SUT.

Adresa: Rruga e Durrësit, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al), web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

- Njëpërmjet shkresës me nr. prot.1516/1, datë 10.06.2019, SUT ka reflektuar vetëm korrespondencën zyrtare shkresore me ankuesin dhe jo kërkesat e KMD-së<sup>7</sup>. Në thelb korrespondenca ka të bëjë me kthim përgjigje ankuesit lidhur me dërgimin e dokumentacionit të dosjes së tij personale.
2. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr.10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës së F. B, Komisioneri me datë 29.08.2019<sup>8</sup> realizoi një seancë dëgjimore me palët në proces.

Seanca u zhvillua vetëm me praninë e palës ankuese, F. B, i cili u qëndroi të njëjtave parashtrime që ka paraqitur në ankesën e tij. Ankuesi theksoi faktin se vetëm ai është transferuar nga i gjithë stafi infermior, duke e kaluar pa dëshirën e tij nga Urgjenca e Tiranës, pranë SUT, në Klinikën e Kirurgjisë nr.2, në Shërbimin e Konsultave të Specializuara Ambulatore, në SUT; gjë e cila ka ardhur si pasojë e prononcimeve të tij në media, lidhur me gjendjen e Urgjencës së Tiranës, ku ai shërbente. Ai parashtrroi se do të dërgonte në vijim listën emërore të tyre, për të cilën kërkoi nga Komisioneri të konfirmonte vërtetësinë e saj pranë SUT-së.

Nga ana e SUT nuk u paraqit asnjë përfaqësues, por paraprakisht njëpërmjet shkresës me nr.2275 prot., datë 26.08.2019 ka dërguar pranë KMD-së, parashtrimet si dhe një pjesë të dokumentacionit të kërkuar. Njëpërmjet kësaj shkrese SUT ka informuar KMD-në se:

- *“F. B është transferuar nga ARSH Tiranë, me detyrë Infermier në Shërbimin e Urgjencës Ambulatore në SUT, në datën 01.01.2016 dhe në këtë datë i kanë filluar marrëdhëniet e punës me SUT. Transferimi i personelit është bërë me Urdhër të Ministrit të Shëndetësisë, nr.38, datë 01.02.2016 “Për transferimin e personelit të Shërbimit të Urgjencës Mjekësore, Tiranë”. Gjatë kësaj periudhe në funksionin organik Infermier pranë këtij Shërbimi, z.B për mangësi dhe të meta në punë i janë dhënë masat disiplinore si më poshtë citohen:*
- *Me Urdhërin nr.2471, datë 13.11.2018 “Urdhër për dhënie mase disiplinore personeli punonjës në SUT”, i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”, me motivacionin për thyerje të kërkesave të pikës 1, të Deklaratës së Konfidencialitetit, si dhe dhënie informacioni pa qenë i autorizuar nga SUT, dhënie informacioni të SUT në TV private dhe portale private pa autorizim.*
- *Me Urdhërin nr.2782, datë 20.12.2018 “Urdhër për dhënie mase disiplinore personeli punonjës në SUT”, i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna”, me motivacionin “Moszbatim të Urdhërit nr.1558, datë 20.08.2018, për përdorimin e uniformës së punës gjatë orarit zyrtar të punës, konstatuar nga ekipi i kontrollit të SUT me datë 14.12.2018, në vendqëndrimin “Stadiumi Dinamo”.*

- 
- Informacion nëse në vend të ankuesit është emëruar një punonjës/e tjetër. Nëse po, një kopje e dosjes personale si dhe kopje të procedurës së ndjekur për emërimin e tij/saj.
  - Kopje e procedurës së ndjekur lidhur me dhënien e dy masave disiplinore ndaj ankuesit.

Kopje të akteve me të cilat ankuesi ka kundërshtuar masat disiplinore ndaj tij, si dhe përgjigjet e SUT për secilin rast

<sup>7</sup> Referuar shkresës me nr.814/1 prot., datë 07.06.2019 të KMD-së.

<sup>8</sup> Referuar “Njoftimit për seancë dëgjimore” me nr.814/4 prot., datë 14.08.2019.

Adresa: Rruga e Durrësit, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al), web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

Nga ana e SUT është argumentuar se, masat disiplinore sa më sipër, ndaj ankuesit, janë dhënë sepse ka thyer rëndë kërkesat e Deklaratës së Konfidencialitetit që ka nënshkruar vetë, si dhe urdhërat e Drejtorisë së SUT-së.

Në vijim të përgjigjes, SUT ka cituar se: *“F. B për nevoja pune dhe shërbimi në Shërbimin e Konsultave të Specializuara Ambulatore në SUT, me Vendimin nr.426, datë 08.02.2019 “Vendim për komandim në detyrë personel infermieror në SUT”, është komanduar të punojë, deri në një urdhër të dytë, Infermier Shërbimi i Kirurgjisë nr.2. Nga data 11.02.2019-16.02.2019 z.B ka qenë me raport-mjekësor. Nga data 18.02.2019-17.03.2019 ka marrë me kërkesën e tij 28 ditë leje të zakonshme të vitit 2019. Nga data 18.03.2019-18.04.2019 ka marrë me kërkesën e tij 30 ditë leje pa të drejtë page. Pas përfundimit të 30 ditëve leje pa të drejtë page, me datë 19.04.2019, F. B duhet të paraqitet në punë në detyrën si “Infermier i komanduar” në Shërbimin e Konsultave të Specializuara Ambulatore në SUT. Ky komandim ishte deri në një urdhër të dytë, për të përballuar fluksin e pacientëve që vijnë në SUT, si Spital Kombëtar i Traumës, me pacientë nga e gjithë Shqipëria. Është detyrë e autoriteteve të SUT, që për rastet ku konstatohet fluks i madh i pacientëve që vijnë në SUT me politrauma të rënda dhe shumë të rënda (aksidente të ndryshme, plagosje me armë të ftohta, plagosje me armë zjarri, rënie nga lartësitë, raste të thyerjeve të gjymtyrëve, etj) dhe nuk mund të përballohet volumi i punës nga personeli organik i Shërbimit ku është dhe volumi i madh i punës, komandohen personel punonjës nga Shërbimet që kanë më pak ngarkesë me pacientë, të Shërbimet ku volumi i punës është më i madh. Komandime të tilla për personel punonjës infermier dhe mjek bëhen vazhdimisht në SUT. Bazuar në shkresën me nr.239, datë 06.05.2019 të Shërbimit të Konsultave të Specializuara Ambulatore në SUT, F. B nga data 18.04.2019-06.05.2019 nuk është paraqitur në detyrën e Infermierit të komanduar në këtë Shërbim, ka munguar pa arsye, nuk ka njoftuar me shkrim SUT për mungesat që ka bërë si dhe për shkakun pse ka munguar. Në vijim të kësaj shkrese, bazuar në legjislacionin në fuqi, me Urdhërin nr.1264, datë 10.05.2019 “Për ndërprerje marrëdhënie financiare dhe kontratë pune personeli Infermier në SUT”, me motivacionin e mugesave të pajustificuara në punë, F. B i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare dhe kontrata e punës me SUT<sup>9</sup>”.*

SUT ka kundërshtuar pretendimin e ankuesit se është diskriminuar prej tyre, si të pabazuar, pasi komandimi i tij në detyrë ka qenë për një periudhë deri në një urdhër të dytë dhe se pas përfundimit të periudhës së komandimit, me urdhër të SUT do të rikthehej në detyrën që kishte më përpara, Infermier në Shërbimin e Urgjencës Ambulatore. SUT i ka bashkëlidhur shkresës disa urdhëra komandimesh në detyrë për stafin infermieror dhe konkretisht:

- Për vitin 2018 rezultojnë se janë urdhëruar 8 komandime në detyrë (A.N, F.R, F.SH, I.M, A.Ç, E.Z)
- Për vitin 2019 rezultojnë (përveç F. B) vetëm tre komandime në detyrë për z.M.Z, znj.D.R dhe znj.V.T, të cilat i përkasin periudhës prill-maj 2019.

SUT ka informuar Komisionerin se në rastet e komandimeve në detyrë, trajtimi financiar i punonjësve nuk ndryshon, pasi ata marrin pagën mujore të funksionit ku janë emëruar, por SUT nuk ka i bashkëlidhur shkresës asnjë dokument provues lidhur me sa më sipër.

<sup>9</sup> Marrëdhëniet financiare janë ndërprerë me datë 18.03.2019.

Adresa: Rruga e Durrësit, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al), web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

SUT citon se: *“Në pozicionin si Infermier Shërbimi i Kirurgjisë nr.2, në Shërbimin e Konsultave të Specializuara Ambulatore në SUT, shërbejnë personeli me më përvojë, me stazh të gjatë pune mbi 15-20 vjet. Procedura e punës e kërkon që të jenë infermierë me eksperiencë pune, më të kualifikuarit, më të përgjegjshmit me detyrën, me kodin e komunikimit, të qartë e të qetë dhe informues për problemet shëndetësore që shfaqin dhe kanë pacientët. Në këtë Shërbim paraqiten çdo ditë me qindra raste pacientësh që marrin shërbimin mjekësor në shkallën më të lartë të profesionalizmit nga personeli Inferimerë dhe Mjekë të SUT”.*

3. Me datë 04.09.2019, subjekti ankues nëpërmjet e-mailit personal<sup>10</sup> ka dërguar pranë KMD-së listën emërore të stafit infermieror të Urgjencës së Tiranës, pranë SUT-së, dhe pretendon se asnjë prej tyre nuk është transferuar.
4. Në vijim të procedurës hetimore për marrjen e çdo prove dhe informacioni që i shërben procesit, nëpërmjet shkresës me nr.1327 prot., datë 04.09.2019 Komisioneri ka kërkuar nga SUT informacion dhe dokumentacion shtesë<sup>11</sup>, lidhur me sa mësipër pretendon ankuesi.

Lidhur me sa mësipër, Komisioneri thekson faktin se, nga ana e SUT-së, nuk është sjellë asnjë informacion apo dokumentacion i kërkuar nëpërmjet shkresës sipërcituar, megjithëse Institucioni kishte marrë dijeni<sup>12</sup>.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin e paligjshëm dhe të padrejtë të pretenduar nga ankuesi.**

- a) **Lidhur me trajtimin e paligjshëm dhe të padrejtë të pretenduar nga ankuesi, përsa i takon masave disiplinore të dhëna ndaj tij.**

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 1 sipërcituar dhe neni 3/1, parashikojnë se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të*

---

<sup>10</sup> fb@live .com

<sup>11</sup> - Sa është numri i infermierëve që kanë qenë të emëruar pranë Shërbimit të Urgjencës Ambulatore Tiranë, deri në muajin Shkurt 2019? (Kopje të listës emërore të tyre).

- Sa nga këta infermierë janë transferuar nga muaji Shkurt 2019 e deri aktualisht? (Kopje të procedurës së ndjekur lidhur me komandimet e tyre, rast pas rasti, nëse ka).
- Informacion nëse punonjësit e poshtëcituar (listë emërore e vënë në dispozicion nga subjekti ankues) kanë qenë të punësuar dhe vijnë të jenë dhe aktualisht pranë Shërbimit të Urgjencës Ambulatore Tiranë: F.L, S.K, R.M, A.B, S.M, M.B, K.K, F.P, V.P, E.GJ, J.C, E.K, E.M, A.V. Nëse jo, kopje të procedurës lidhur me emërimet/komandimet e tyre aktuale.
- Vërtetim të pagës së F. B në detyrën e infermierit të Shërbimit të Urgjencës Ambulatore (përfshirë: Pagë grupi, shtesë pozicioni, vështirësi, nëse ka, dhe vjetërsi).
- Vërtetim të pagës së punonjësit në detyrën e infermierit të Shërbimit të Kirurgjisë në Shërbimin e Konsultave të Specializuara Ambulatore në SUT. (përfshirë: Pagë grupi, shtesë pozicioni, vështirësi, nëse ka, dhe vjetërsi).

<sup>12</sup> Referuar kuponit postar të lajmërim-marrjes, me bar kod: RR 890 795 635 AA.

Adresa: Rruga e Durrësit, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al), web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

*përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezultoi se:

Subjekti ankues ka një eksperiencë pune si infermier prej rreth 30 vitesh. Ai ka lidhur marrëdhëniet e punës me Autoritetin Shëndetësor Rajonal Tiranë (ARSH), me datë 28.05.2011<sup>13</sup> në detyrën e infermierit të Urgjencës, nëpërmjet Kontratës Individuale të punës, për një afat të pacaktuar kohor.

Në datën 01.01.2016 F. B është transferuar nga ARSH Tiranë, me detyrë Infermier në Shërbimin e Urgjencës Ambulatore në SUT, datë kur dhe i kanë filluar marrëdhëniet e punës me SUT. Ky transferim është bërë me Urdhër të Ministrit të Shëndetësisë, nr.38, datë 01.02.2016 “Për tansferimin e personelit të Shërbimit të Urgjencës Mjekësore, Tiranë”. Me datë 01.01.2017 F. B është emëruar Infermier në Shërbimin e Urgjencës Ambulatore në SUT, për një afat të pa caktuar kohor.

Referuar akteve shkresore të dosjes së ankuesit, rezulton se ndaj tij, gjatë vitit 2018 janë dhënë dy masa disiplinore, ndërkohë që për periudhën e mëparëshme të punës nuk rezultojnë masa disiplinore ndaj tij. Kështu:

- Me Urdhërin nr.2471, datë 13.11.2018 “Urdhër per dhënie mase disiplinore personeli punonjës në SUT”, i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”, me motivacionin për thyerje të kërkesave të pikës 1, të Deklaratës së Konfidencialitetit<sup>14</sup>, si dhe dhënie informacioni pa qenë i autorizuar nga SUT, dhënie informacioni të SUT në TV private dhe portale private pa autorizim.

Megjithëse është kërkuar shkresërisht nga KMD disa herë, që të sillej e gjithë procedura e ndjekur për marrjen e masave disiplinore ndaj ankuesit, SUT:

- Lidhur me masën e parë disiplinore, ka vënë në dispozicion vetëm Urdhërin nr.2471, datë 13.11.2018. Ndërkaq, vërehet se masa disiplinore sa më sipër nuk ka të bashkëlidhur asnjë akt tjetër shkresor, bazuar në të cilin të ishte shpjeguar, konstatuar apo provuar shkelja e pretenduar nga SUT.

Nga ana tjetër, nëpërmjet shkresës që mban datën 16.11.2018, e cila rezulton të jetë protokolluar pranë SUT me nr.17-F prot., datë 25.12.2018, ankuesi ka paraqitur observacionin e tij nëpërmjet të cilit kundërshton këtë masë disiplinore si të padrejtë dhe të qëllimshme ndaj tij, duke akuzuar institucionin se kanë shmangur dhe nuk kanë pranuar që atij t’i protokolloheshin shkresat në kohë.

<sup>13</sup> Referuar Kontratës Individuale të Punës.

<sup>14</sup> Pika 1 e Deklaratës së Konfidencialitetit citon shprehimisht: “Me anë të kësaj deklarate marr përsipër të mos përdor dhe të mos i transmetoj personave të paautorizuar të dhëna personale apo informacione konfidenciale në lidhje me ose të marra nga SUT, përveç nëse autorizohem shprehimisht nga SUT, ose kërkohet me ligj. Unë e ekuptoj se ky detyrim vlen gjatë afatit të punësimit si dhe pas përfundimit të tij”.

Adresa: Rruga e Durrësit, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al), web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

Komisioneri është informuar vetëm nëpërmjet kësaj shkrese të ankuesit lidhur me rrethanat dhe faktet mbi të cilat SUT ka dhënë masën disiplinore.

Lidhur me dhënien e kësaj mase disiplinore, nisur nga kronologjia e ngjarjeve, Komisioneri vëren se:

Është fakt i njohur botërisht se F. B, me datë 28.10.2018 ka dalë në TV News 24, ku ka folur në një minutazh prej rreth 44 minutash lidhur me sfidat, mangësitë dhe vështirësitë që hasin në përditshmërinë e punës së tyre, mjekët, infermierët dhe shoferët e Urgjencës së Tiranës, duke e lidhur me mungesën e kushteve dhe mjeteve të punës, mungesën e medikamenteve etj, gjëra të cilat ndikojnë drejtëpërdrejtë në pamundësinë e tyre për t'u ofruar me efektivitet dhe në mënyrën e duhur ndihmën mjekësore pacientëve/qytetarëve që kanë nevojë për të. Në të njëjtën intervistë, ankuesi ka informuar lidhur me përfshirjen e një ambulance të Urgjencës së Tiranës, pak ditë përpara kësaj interviste, në një aksident të ndodhur tek "Rruga e Kavajës", si pasojë e të cilit mjeku i ekipit, z.A.D kishte thyer krahun, infermieri, z.R.C kishte pësuar shëmbje, si dhe ishte gjakosur pacienti. Situata kjo e ardhur pikërisht si pasojë e mosfunksionimit siç duhet të ambulancës dhe mospajisjes së saj me mjetet e punës. Këto denoncime ankuesi i mbron me argumentin se i ka bërë për përmirësimin e situatës së stafit të Urgjencës Tiranë por dhe të pacientëve/qytetarëve që u ofrohet shërbimi mjekësor, nisur edhe nga cilësia e tij si zv/president i Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë.

Shoqata e Infermierëve të Shqipërisë është e regjistruar si personi juridik, nëpërmjet Vendimit nr. 5489, datë 02.12.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Referuar vendimit të sipërpërmendur, citohet: "*Objektivat bazë të Shoqatës janë: monitorimi i zhvillimit të disiplinave shkencore dhe profesionale të infermierëve, integrimi dhe përmirësimi i trajnimit shkencor dhe profesional të infermierëve në bashkëpunim me universitetet dhe institucionet e tjera, në bashkëpunim me shoqatat e tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe mbrojtjen e infermierëve, kur atyre u shkelen të drejtat e tyre*". Një parashikim i tillë gjendet edhe në nenin 6, të Aktit të Themelimit të Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë, miratuar në datën 04.11.2016 nga të gjithë anëtarët themelues, si dhe në Pjesën III, nenin 7, të Statutit të kësaj Shoqate.

Nga ana tjetër, F. B është dhe anëtar i Urdhërit të Infermierëve të Shqipërisë.

Statuti i Urdhërit të Infermierëve në Republikën e Shqipërisë<sup>15</sup> në nenin 7, të tij ka përcaktuar se: "*Asnjë individ nuk mund ta ushtrojë profesionin e infermier/e, mami, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie, logopedist/e në Republikën e Shqipërisë pa qënë anëtar i Urdhërit të Infermierit. Punëdhënësit e institucioneve shëndetësore, publike dhe private, të shërbimit shëndetësor parësor, dytësor dhe tretësor, ndalohen t'i punësojnë në kundërshtim me këtë dispozitë*".

Referuar sa mësipër, detyra e ankuesit si Infermier dhe si zv//president i Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë është mbrojtja e të drejtave të infermierëve po aq sa dhe mbrojtja e interesave dhe të drejtave të pacientëve dhe të publikut, sa i takon ofrimit të kujdesit mjekësor.

Pikërisht në referencë të parashikimeve të bëra në aktet e mësipërme, subjekti ankues ka vepruar në mbrojtje të të drejtave të infermierëve dhe të pacientëve/publikut, duke filluar që nga deklaratat

<sup>15</sup>

Urdhri i Infermierit është krijuar në bazë të Ligjit Nr. 9718 datë 19/04/2007, ndryshuar me Ligjin Nr. 10 462 datë 13/09/2011, ndryshuar me Ligjin Nr. 124 datë 25/09/2014 "Për Urdhërin e Infermierit në Republikën e Shqipërisë".

Adresa: Rruga e Durrësit, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al), web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)



dhe intervistat në shtypin e shkruar dhe atë viziv, e deri në përpjekjet për zhvillimin dhe organizimin e protestave të ndryshme, në cilësinë e zv/presidentit të Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë, duke patur detyrimin të llojë për interesat dhe të drejtat e tyre.

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se roli i tij është i rëndësishëm dhe aspak në shkelje të Deklaratës së Konfidencialitetit, përkundrazi ankuesi ka përmbushur detyrimin e tij për identifikimin dhe adresimin e këtyre problematikave jetike si për infermierët ashtu dhe për pacientët/publikun.

Në rastin konkret, Komisioneri gjykon se si pasojë e reagimit të ankuesit, në intervistat e dhëna në media të ndryshme vizive, të shkruara dhe online, kryesisht që nga muaji tetor 2018 e në vijim, nëpërmjet së cilave ai ka synuar denoncimin e gjendjes kritike në të cilën ndodhej Urgjenca e Tiranës, kushtet e papërshtatshme të ushtrimit të detyrës së stafit mjekësor aty si dhe shkeljen e të drejtës së pacientëve për t'u shërbyer me efikasitet dhe dinjitet; me datë 13.11.2018, ndaj tij është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”.

Nga ana e SUT është shkelur e drejta e ankuesit për të patur një proces të rregullt, të drejtë dhe ligjor, për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur ndaj masës së dhënë, duke bërë që ky proces të jetë krejtësisht njëanshëm dhe i padrejtë nga ana e SUT.

- Lidhur me masën e dytë disiplinore, Komisioneri vëren se, rreth një muaj pas dhënies së masës së parë disiplinore, ankuesit i është dhënë një masë tjetër.

Me Urdhërin nr.2782, datë 20.12.2018 “Urdhër për dhënie mase disiplinore personeli punonjës në SUT”, i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna”, me motivacionin “Moszbatim të Urdhërit nr.1558, datë 20.08.2018, për përdorimin e uniformës së punës gjatë orarit zyrtar të punës, konstatuar nga ekipi i kontrollit të SUT me datë 14.12.2018, në vendqëndrimin “Stadiumi Dinamo”. Bashkëlidhur kësaj mase, SUT ka sjellë si provë dokumentuese shkresën “Akt-Kontrolli” me nr.2713/1 prot., datë 18.12.2018. Në këtë “Akt-Kontroll” të mbajtur me datë 14.12.2018, ora 11:05, evidentohen këto fakte:

- Ekipi i kontrollit është përbërë nga, znj.L.S në detyrën e Kryeinfermieres së Përgjithshme të SUT dhe z.V.S në detyrën e Përgjegjës të Sektorit të Shërbimeve të Brendshme të SUT.
- Nuk është depozituar (megjithëse është kërkuar kopje e gjithë procedurës së ndjekur për ecurinë e dhënies së masave disiplinore naj ankuesit) asnjë akt shkresor ku të jetë urdhëruar ngritja e këtij ekipi kontrolli, as përbërja dhe qëllimi për të cilin është ngritur, pavarësisht faktit që tek “Akt- Kontrolli” është cituar Urdhëri nr.2713, datë 13.12.2018 i Drejtorit të SUT.
- Është ushtruar kontroll për verifikimin e prezencës së personelit në orarin zyrtar të punës, për veshjen e uniformave nga ana e personelit si dhe në qoftë se kishte ndryshime në grafikun e personelit, tek Shërbimi i Urgjencës së Tiranës që ndodhet tek Senatoriumi “Shefqet Ndroqi”, tek Urgjenca e Tiranës që ndodhet pranë Stadiumit “Dinamo” dhe tek Urgjenca e Spitalit Universitar të Traumës.

- Për stafin e Urgjencës së Tiranës me vendqendrim tek Senatoriumi “Shefqet Ndroqi”, është konstatuar se nuk ndodhej në ambjentet e punës.
- Për stafin e Urgjencës së Tiranës me vendqendrim pranë Stadiumit “Dinamo”, është konstatuar se ndodhej në vendin e punës gjatë orarit zyrtar dhe se personeli mbante veshur uniformën e punës, përveç infermierit Frrok Bardhi, i cili nuk kishte të plotësuar veshjen e ushtrimit të profesionit.
- Për stafin e Urgjencës së Tiranës me vendqendrim pranë SUT, është konstatuar se nuk ndodhej në ambjentet e punës.
- Për rastet kur stafet e Urgjencës nuk janë ndodhur në vendin e punës në momentin e ushtrimit të kontrollit, i është lënë detyrë Shefit të Shërbimit të Urgjencës Ambulatore, z.A.K, që të dërgonte informacion me shkrim se ku ka qenë personeli në datën dhe orën e ushtrimit të kontrollit.

Bazuar në konstatimet e këtij Akt-Kontrolli, nëpërmjet urdhërit nr.2782 prot., datë 20.12.2018, ankuesit i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna”.

Lidhur me dhënien e kësaj mase disiplinore, Komisioneri vëren se:

- Nga ana e SUT nuk rezulton të jetë ndjekur një procedurë e ligjshme ndaj ankuesit, sikurse dhe në rastin e dhënies së masës së parë disiplinore ndaj tij. Nëpërmjet shkresës me nr.17-F prot., datë 25.12.2018, ankuesi ka sqaruar dhe argumentuar arsyet se përse ai në momentin e ushtrimit të kontrollit nga ekipi i kontrollit ka qenë i veshur vetëm me pjesën e sipërme të uniformës dhe i nuk ka patur të veshur pjesën e poshtme/ pantallonat e saj. Ankuesi ka sqaruar se pantallonat e uniformës, për shkak të kushteve të papërshtatshme të tualetit të Urgjencës së Tiranës me vendqendrim pranë Stadiumit “Dinamo”, i ka patur të ndotura pikërisht për këtë shkak dhe prandaj në momentin e kontrollit ka patur të veshur vetëm bluzën nga uniforma e punës.
- Nuk rezulton që nga ana e SUT të jenë marrë masa të paktën për të verifikuar një pretendim të tillë apo për ta dokumentuar atë, megjithëse ankuesi pretendon se ua ka vërtetuar këtë pretendim, duke u treguar pantallonat e ndotura.
- Nga ana tjetër, Komisionerit nuk i është vënë në dispozicion asnjë argumentim apo akt shkresor provues për t’u njohur me faktin se si ka vijuar nga ana e SUT verifikimi për dy stafet e Urgjencave të Tiranës me vendqëndrime tek Senatoriumi “Shefqet Ndroqi” dhe pranë SUT, të cilat nga i njëjti akt-kontroll rezultuan që nuk ishin në vendin e punës në momentin e kontrollit. Mundet që nga përgjigjja e Shefit të Shërbimit të Urgjencës Ambulatore, z.A.K, të rezultonte që ata të kishin qenë me shërbim, por për sa kohë ky informacion nuk është dhënë dhe as provuar nga ana e SUT-së, Komisioneri vlerëson se ankuesi është trajtuar në mënyrë të pafavorshme krahasuar me ta, pasi atij i është dhënë masë disiplinore “Paralajmërim për pushim nga puna”, ndërsa për ata prezumohet se nuk është ndërmarrë asnjë masë disiplinore, megjithë konstatimin për mosprezencë në vendin e punës.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e

subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Kodi i Procedurës Administrative<sup>16</sup>, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast SUT, i cili duhet të provonte se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë, për shkakun e pretenduar prej tij.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”*.

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin në përmbushjen e detyrave të tij, veçanërisht duke i dhënë informacionin që i nevojitet atij”*.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Komisioneri gjykon se masa disiplinore “Paralajmërim për pushim nga puna” është jo proporcionale në raport me shkeljen e konstatuar. Shpjegimi i ankuesit nuk është marrë në konsideratë, pasi ai ka patur të veshur bluzën e uniformës çka e bënte të identifikueshëm atë si personel infermior të Urgjencës së Tiranës, dhe për më tepër fakti që nuk kishte të veshura pantallonat e uniformës nuk përbënte shkelje të natyrës së rëndë që të rrezikonte dhënien e ndihmës pacientëve apo ushtrimin e profesionit dhe detyrës së tij.

Dhënia e masave disiplinore është pjesë e mjeteve ligjore për mbrojtjen e punëdhënësit, në rastet kur punëmarrësi nuk i respekton rregullat dhe normat kontraktore dhe ligjore. Masa disiplinore jepet për të përmirësuar performancën e punëmarrësit dhe për të parandaluar dëmet ndaj punëdhënësit dhe ndaj të tretëve, që mund të përfitojnë shërbimin apo mallrat e punëdhënësit. Masat disiplinore duhet të jepen duke respektuar parimin e proporcionalitetit, që parashikon se për një shkelje të lehtë, duhet të jepet masë disiplinore e lehtë e më tej duke u përshkallëzuar. Masa disiplinore duhet të dokumentohet, të materializohet dhe t’i bëhet me dije punëmarrësit në kohën kur jepet, sepse ai ka të drejtën e ankimit ndaj masës, si dhe për faktin se masat disiplinore më të lehta parashkruhen me kalimin e afateve të caktuara ligjore.

---

<sup>16</sup>Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*.

Adresa: Rruga e Durrësit, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al), web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

Nëse procedura e njoftimit apo e masës disiplinore do të respektohet, atëherë pa diskutim që punëdhënësi ka të drejtë ta përshkallëzojë dhënien e masës deri në ekstremin e saj. Në të kundërt, nëse punëdhënësi nuk e provon këtë gjë, atëherë ai mund të abuzojë me preteksin e shkeljes së disiplinës për të pushuar nga puna çdo punëmarrës.

Nga ana e SUT nuk u sollën prova dhe argumentime bindëse që të mund të provonin apo përligjinin faktin se masat disiplinore ndaj ankuesit dhe cilësimi i tyre të kenë ardhur për arsye të ligjshme apo të ishin proporcionale.

SUT jo vetëm që nuk dha shpjegim objektiv, të justifikueshëm dhe të besueshëm, por shpjegimet e dhëna prej saj, janë të pabazuara në provat e administruara dhe në kundërshtim me mbrojtjen ligjore që i ofrohet punëmarrësit në marrëdhëniet e punës.

**b) Lidhur me trajtimin e paligjshëm dhe të padrejtë të pretenduar nga ankuesi, përsa i takon komandimit të tij nga Infermier në Shërbimin e Urgjencës Ambulatore, pranë SUT-së, në Infermier Shërbimi i Kirurgjisë nr.2, në Shërbimin e Konsultave të Specializuara Ambulatore në SUT.**

Referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës, rezulton se nëpërmjet shkresës me nr.426 prot., datë 08.02.2019, “Vendim për komandim në detyrë personel infermieror në SUT”, subjekti ankues me detyrë Infermier në Shërbimin e Urgjencës Ambulatore në SUT, për nevoja pune dhe shërbimi, është komanduar të punojë Infermier Shërbimi i Kirurgjisë 2, në Shërbimin e Konsultave të Specializuara Ambulatore në SUT, nga data 08.02.2019 deri në një urdhër të dytë.

Nëpërmjet shkresës me nr.939 prot., datë 06.05.2019 të Shërbimit të Konsultave të Specializuara Ambulatore në SUT, rezulton se subjekti ankues:

- Nga data 11.02.2019-17.02.2019 ka qenë me raport mjekësor.
- Nga data 18.02.2019 deri me datë 17.03.2019 ka marrë lejen e zakonshme dhe nga data 18.03.2019 deri me datë 18.04.2019 për arsye familjare ka marrë leje pa të drejtë page.

F. B ka refuzuar të pranojë komandimin pranë këtij Shërbimi, fakt për të cilin ka vënë në dijeni Burimet Njerëzore. (Shkresa me nr.02-F prot., datë 20.03.2019)

Nëpërmjet kësaj shkrese, ai bën me dije strukturat e SUT se komandimi i tij është i padrejtë dhe tendencioz si pasojë e përfshirjes së tij në denoncime publike mediatike, në mbrojtje të shërbimit të Urgjencës së Tiranës, për përmirësimin e dhënies së ndihmës së pacientit, përmirësimin e kushteve të punës, furnizimin me mjete dhe aparatura mjekësore etj.

Në vijim, bazuar në Urdhërin nr.1264, datë 10.05.2019 “Për ndërprerje marrëdhënie financiare dhe kontratë pune personeli Infermier në SUT”, me motivacionin e mugesave të pajustificuara në punë, atij i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare.

Për sa mësipër, Komisioneri vlerëson se, megjithëse SUT ka patur dijeni që ankuesi ka refuzuar të punojë Infermier Shërbimi i Kirurgjisë 2, në Shërbimin e Konsultave të Specializuara Ambulatore

në SUT dhe ia ka bërë të ditur shkresërisht këtë fakt SUT<sup>17</sup>, sërisht SUT ka vijuar të argumentojë dhe dokumentojë largimin e tij nga puna, me arsyen e mosprezencës së tij në vendin e punës.

Lidhur me sa sipërcituar, **Komisioneri vlerëson se kalimi/komandimi i ankuesit nga Infermier në Shërbimin e Urgjencës Ambulatore në SUT, në Infermier Shërbimi i Kirurgjisë nr.2, në Shërbimin e Konsultave të Specializuara Ambulatore në SUT; është në fakt ndërprerje e kontratës të punës, pasi kanë ndryshuar elementët thelbësore të saj.**

Në kontekst të sa mësipër, Komisioneri nuk do marrë në konsideratë pretendimin e ankuesit për komandim/transferim të padrejtë dhe të pafavorshëm krahasuar me infermierët e tjerë të Urgjencës së Tiranës, pasi në vetvehte komandimi/transferimi i tij është zgjidhje e njëanshme e kontratës së tij të punës.

Me shkresën me nr.02-F prot., datë 20.03.2019, ankuesi ka kundërshtuar komandimin e tij dhe kërkon nga SUT të rikthehet në vendin e mëparshëm të punës.

Komandimi i tij ka sjellë si pasojë edhe ndryshimin e kushteve të kontratës të punës në dëm të tij, në mënyrë të njëanëshme, çka në fakt është dhe zgjidhje e saj. Kontrata individuale e punës ishte lidhur për një kohë të pacaktuar, duke filluar nga data 01.01.2017.

Njëherësh me ndryshim e pozicionit dhe vendit të punës, është prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe një element thelbësor i kontratës, siç është paga. Neni 110, pika 1 e Kodit të Punës, përcakton se: "Punëdhënësi i paguan punëmarrësit pagën sipas dispozitave të kontratës kolektive ose kontratës individuale...".

Ligji nr. 10 221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", neni 12, pika 1, germa c), parashikon se: "Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:

...c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës".

- Lidhur me ndryshimin e elementit pagë.

Argumentimi i SUT lidhur me kërkesën e Komisionerit nëse elementi pagë i ankuesit do të pësonte ndryshime nga ky komandim, ishte se trajtimi financiar në rastet e komandimeve nuk ndryshon dhe si dokumentacion provues kanë dërguar dokumentin ku citohet se, paga mujore e F. B, me detyrë Infermier, Shërbimi i Urgjencës Ambulatore, është:

Pagë grupi = 11 000 lekë

Shtesë pozicioni = 24 000 lekë

Vështirësi = S'ka

Vjetërsi pune = 25 vite

Pra, sa më sipër, SUT referon se paga e ankuesit ishte 35 000 lekë, duke llogaritur dhe shtesën për vjetërsi pune.

<sup>17</sup> Shkresa me nr.02-F prot., datë 20.03.2019.

Adresa: Rruga e Durrësit, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al), web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

Ndërsa, referuar dokumentacionit të sjellë në cilësi prove nga ankuesi, rezulton një situatë e ndryshme e trajtimit të tij financiar.

Nëpërmjet shkresës me nr.2/2 prot., datë 02.09.2019 të firmosur nga Drejtori i SUT, dokument i cili mban vulën e këtij Institucioni, provohet se paga e tij si Infermier në Shërbimin e Urgjencës Ambulatore në SUT, deri në datën 18.03.2019, që ka qenë me leje të zakonshme ka qenë kjo:

Pagë grupi = 10 000 lekë

Shtesë pozicioni = 30 000 lekë

Shtesë për vjetërsi pune = 5 000 lekë

Shtesë për kushte pune = 1800 lekë

Shtesë për natyrë të veçantë = 12 000 lekë

Pra, në total paga e tij ka qenë rreth 60 000 lekë, gjë që e provon edhe nëpërmjet dokumentacionit bankar, ekstrakteve të nxjerra nga pagesat e realizuara nëpërmjet Degës Credins, Laprakë, për një periudhë rreth një vjeçare (Janar 2018-Mars 2019).

Është lehtësisht e provueshme se trajtimi financiar i ankuesit në pozicionin e komanduar do të pësonte rënie të ndjeshme. Për më tepër, Komisioneri thekson se ky komandim/transferim nuk ka ardhur si rezultat i ndonjë mase disiplinore, ku ankuesi të ishte “ndëshkuar” me zbritje në detyrë dhe për këtë shkak argumentimin e tyre se trajtmi financiar nuk ka ndryshuar e gjen të paprovuar.

Nga shqyrtimi i dokumenteve të administruara nga Komisioneri dhe kronologjia e ngjarjeve, rezulton se:

- **Denoncimet e z.B kanë kulmuar me datë 28.10.2018** me daljen e tij në TV News 24, ku ka folur në një minutazh prej rreth 44 minutash lidhur me sfidat, mangësitë dhe vështirësitë që hasin në përditshmërinë e punës së tyre, mjekët, infermierët dhe shoferët e Urgjencës së Tiranës, duke e lidhur me mungesën e kushteve dhe mjeteve të punës, mungesën e medikamenteve etj, gjëra të cilat ndikojnë drejtëpërdrejtë në pamundësinë e tyre për t’u ofruar me efektivitet dhe në mënyrën e duhur ndihmën mjekësore pacientëve/qytetarëve që kanë nevojë për të.
- Me Urdhërin nr.2471, datë 13.11.2018 **“Urdhër per dhënie mase disiplinore personeli punonjës në SUT”, ankuesit i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”, me motivacionin për thyerje të kërkesave të pikës 1, të Deklaratës së Konfidencialitetit, si dhe dhënie informacioni pa qenë i autorizuar nga SUT, dhënie informacioni të SUT në TV private dhe portale private pa autorizim.**
- Me Urdhërin nr.2782, datë 20.12.2018 **“Urdhër per dhënie mase disiplinore personeli punonjës në SUT”, ankuesit i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna”, me motivacionin “Moszbatim të të Urdhërit nr.1558, datë 20.08.2018, për përdorimin e uniformës së punës gjatë orarit zyrtar të punës, konstatuar nga ekipi i kontrollit të SUT me datë 14.12.2018, në vendqendrimin “Stadiumi Dinamo”.**
- Nëpërmjet shkresës me nr.426 prot., datë 08.02.2019, **“Vendim për komandim në detyrë personel infermieror në SUT”, subjekti ankues me detyrë Infermier në Shërbimin e Urgjencës Ambulatore në SUT, për nevoja pune dhe shërbimi, është**

**komanduar të punojë Infermier Shërbimi i Kirurgjisë 2, në Shërbimin e Konsultave të Specializuara Ambulatore në SUT, nga data 08.02.2019 deri në një urdhër të dytë.**

- Ky komandim nuk ka ardhur si pasojë e masave disiplinore, por nga shpjegimet e SUT, citohet se është bërë për nevoja pune dhe shërbimi. Në shkresën e SUT, në përgjigje të kërkesës së Komisionerit lidhur me cilësitë dhe kriteret e kërkuara për detyrën në të cilën ishte komanduar z.B, citohet se, në pozicionin si Infermier Shërbimi i Kirurgjisë nr.2, në Shërbimin e Konsultave të Specializuara Ambulatore në SUT, shërbejnë personeli me më përvojë, me stazh të gjatë pune mbi 15-20 vjet. Procedura e punës e kërkon që të jenë infermierë me eksperiencë pune, më të kualifikuarit, më të përgjegjshmit me detyrën, me kodin e komunikimit, të qartë e të qetë dhe informues për problemet shëndetësore që shfaqin dhe kanë pacientët.
- Referuar këtij përshkrimi duket sikur ankuesin e kanë komanduar me ngritje në detyrë, por në fakt rezulton e kundërta, pasi bazuar në pagën për këtë pozicion ai trajtohet pothuajse me gjysmën e pagës së mëparëshme. Në këtë kontekst, Komisioneri konstaton se SUT nuk ka ndjekur një linjë logjike lidhur me komandimin e ankuesit dhe ka dështuar të provojë se ka ardhur për një arsye të ligjshme dhe të justifikuar. Po ashtu, nuk ka argumentuar se përse u vlerësua që nga 15 infermierët e emëruar pranë Urgjencës Ambulatore në SUT, u përzgjedh të komandohej pikërisht z.B.
- Pavarësisht se marrëdhëniet e punës i janë ndërprerë nëpërmjet Urdhërit nr.1264, datë 10.05.2019 “Për ndërprerje marrëdhënie financiare dhe kontratë pune personeli Infermier në SUT”, për mosprezencë të justifikuar në punë, **në fakt atij kontrata i është zgjidhur që me datë 08.02.2019.**

Pra, shihet qartë se sjellja e padrejtë ndaj ankuesit, finalizuar me largimin e tij përfundimtar nga puna ka ardhur pikërisht pas denoncimeve të tij publike, mediatike.

## **B. Shkaku i mbrojtur.**

Në ankesën e subjektit ankues pretendohet diskriminim, për shkak shkak të “përkatësisë në një grup të veçantë”, si dhe “çdo shkak tjetër”.

Në lidhje me pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkak të “përkatësisë në një grup të veçantë”, Komisioneri vlerëson se “përkatësia në një grup të veçantë” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi jo vetëm parashikohet si i tillë në LMD, por edhe sepse ekzistojnë prova të mjaftueshme të depozituara pranë KMD-së, që faktojnë se ankuesi e mbart atë. Referuar shkresës me nr.extra prot., datë 10.05.2019 të Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë, F. B është zv/president i kësaj Shoqate. Shoqata e Infermierëve të Shqipërisë është e regjistruar si person juridik, nëpërmjet Vendimit nr. 5489, datë 02.12.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në fokus të veprimtarisë së Shoqatës është mbrojtja e të drejtave të infermierëve, integrimi dhe përmirësimi i trajnimit shkencor dhe profesional të tyre në bashkëpunim me universitetet dhe institucionet e tjera, në bashkëpunim me shoqatat e tjera kombëtare dhe ndërkombëtare; por edhe dhe mbrojtja e interesave dhe të drejtave të pacientëve dhe të publikut, sa i takon ofrimin të kujdesit mjekësor.

Gjithashtu GJEDNJ gjatë praktikës së saj ka zhvilluar disa shkaqe të reja nën kategorinë “për çdo shkak tjetër”. Në këtë kuadër “anëtarësia në një organizatë” është një nga shkaqet e pranuar nga GJEDNJ, në praktiken e saj, si shkak i mbrojtur.<sup>18</sup>

Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje lidhur me një listë joshteruese shkaqesh. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në të njëjtën linjë me parashikimet e LMD, është dhe parashikimi i bërë nga Kodi i Punës, dhe specifikisht, në nenin 9, të tij: “Me “diskriminim” kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me HIV/AIDS, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët”. Në kuptim të këtij neni, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet në lidhje me: “...ç) anëtarësimin dhe aktivizimin në organizata sindikale dhe organizata të punëdhënësve, ose ndonjë organizatë, anëtarët e së cilës ushtrojnë një profesion të caktuar, duke përfshirë përfitimet e siguruar nga këto organizata”.

Në këtë kontekst, ankuesi mund të konsiderohet se bën pjesë në “grupin e veçantë të infermierëve, të grupuar në Shoqatën e Infermierëve të Shqipërisë”.

- Gjatë parashtrimeve të tij, ankuesi ka pretenduar dhe diskriminim “për çdo shkak tjetër”, duke argumentuar dhe provuar se trajtimi i padrejtë ndaj tij ka filluar pas denoncimeve mediatike, televizive dhe online, kryesisht që nga muaji tetor 2018 e në vijim<sup>19</sup>, ku ka denoncuar gjendjen kritike në të cilën ndodhej Urgjenca e Tiranës, kushtet e papërshtatshme të ushtrimit të detyrës së stafit mjekësor aty si dhe shkeljen e të drejtës së pacientëve për t’u shërbyer me efikasitet dhe dinjitet.

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh<sup>20</sup>. Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1.

<sup>18</sup> [https://www.echr.coe.int/Documents/Handbook\\_non\\_discr\\_laë\\_SQL.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/Handbook_non_discr_laë_SQL.pdf) fq.90

<sup>19</sup> <https://www.facebook.com/ëatch/?v=275272546748518>

<sup>20</sup> Neni 1, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 ‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me .....ose me çdo shkak tjetër.”

Adresa: Rruga e Durrësit, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al), web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)



Neni 1, i ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh<sup>21</sup>.

Në mungesë të një praktike kombëtare Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statuse të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14 i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “*me çdo shkak tjetër*”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. **Pretendimi i ankuesit se shkak për diskriminimin e tij është bërë denoncimi i situatës kritike në Urgjencën e Tiranës, qëndron dhe është i provuar, bazuar në opinionet e shprehura prej tij në mediat online dhe ato televizive.**

Denoncimin e kësaj situatë kritike nga ana e ankuesit, për shkak të detyrës/të profesionit, por dhe të tagrit të ankuesit si z/v president të Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë, Komisioneri e vlerëson si shkak të mbrojtur të LMD-së, referuar si “*çdo shkak tjetër*”.

### **C. Lidhja e trajtimit të padrejtë me shkakun e mbrojtur.**

#### **➤ Lidhja e trajtimit të padrejtë të ankuesit me shkaqet e pretenduara prej tij.**

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezulton se subjekti ankues, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë përsa i takon largimit të tij nga puna.

Kodi i Procedurës Administrative, i ndryshuar, si dhe Kodi i Punës në ndryshimet e bëra, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast SUT.

Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: “*Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë*

---

<sup>21</sup> Neni 14, I KEDNJ-së: “*Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër*”.

Adresa: Rruga e Durrësit, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al), web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

*diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.*

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, nga ana e punëdhënësit, jo vetëm nuk u sollën argumenta ose prova për të hedhur poshtë pretendimin e ankuesit, por SUT është në shkelje flagrante të garancisë ligjore që LMD i jep individit/punëmarrësit.

Kështu, sa i takon masave disiplinore ndaj ankuesit, nga ana e SUT nuk u sollën prova dhe argumentime bindëse që të mund të provonin apo përligjinin faktin se masat disiplinore ndaj tij dhe cilësimi i tyre të kenë ardhur për arsye të ligjshme apo të ishin proporcionale.

Po ashtu, Komisioneri vlerëson se kalimi/komandimi i ankuesit nga Infermier në Shërbimin e Urgjencës Ambulatore në SUT, në Infermier Shërbimi i Kirurgjisë nr.2, në Shërbimin e Konsultave të Specializuara Ambulatore në SUT; është në fakt ndërprerje e kontratës të punës, pasi kanë ndryshuar elementët thelbësorë të saj dhe se sjellja e padrejtë ndaj ankuesit, finalizuar me largimin e tij përfundimtar nga puna ka ardhur pikërisht pas denoncimeve të tij publike, mediatike.

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në nenin 3/1, parashikon se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njeh dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta.

Neni 14 i Konventës garanton barazinë “në gëzimin e të drejtave dhe lirive” të përcaktuara në të. Protokollin 12-të i saj ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar

nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe në fushëveprimin e tij sesa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.<sup>22</sup>

Në të njëjtën frymë me KEDNJ, “Karta Sociale Europiane” e rishikuar<sup>23</sup>, dhe shtojca e saj, në nenin 24, pika 3, germa c) kanë parashikuar se: *“Nuk do të përbëjnë arsye të vlefshme për përfundimin e punësimit:... c) bërja e një padie ose pjesëmarrja në proces kundër një punëdhënësi që përshijnë pretendim për shkelle të ligjeve ose rregullave dhe ankim te autoritetet administrative kompetente”*.

Kodi i Punës, i ndryshuar, në nenin 9, të tij ka parashikuar se: *“Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohet çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi”*.

Ky parashikim është në të njëjtën frymë me parashikimet ligjore të LMD-së<sup>24</sup>. Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, është një ligj që rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, si dhe përcakton shkaqet në bazë të cilave ndaj një personi mund të ketë diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Gjithashtu mbështetur në nenin 12 të ligjit 10 221/2010 ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën për punësim, për shkaqet e parashikuara në nenin 1.

Ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 12, pika 1, germa c), parashikon se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ...c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”*.

**Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi krijon dyshimin e arsyeshëm dhe vlerëson se F. B, është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë nga ana e SUT, trajtim i cili ka ardhur si pasojë direkte pas denoncimeve mediatike të z.B të datës 28.10.2018, me daljen e tij në TV News 24, ku ka folur lidhur me sfidat, mangësitë dhe vështirësitë që hasin në përditshmërinë e punës së tyre, mjekët, infermierët dhe shoferët e Urgjencës së Tiranës, duke e lidhur me mungesën e kushteve dhe mjeteve të punës, mungesën e medikamenteve etj, gjëra të cilat ndikojnë drejtëpërdrejtë në pamundësinë e tyre për t’u ofruar me efektivitet dhe në mënyrën e duhur ndihmën mjekësore pacientëve/qytetarëve që kanë nevojë për të. Denoncime të cilat i ka bërë në cilësinë e zv/Presidentit të Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë.**

## **PËR KËTO ARSYE :**

<sup>22</sup> [https://www.echr.coe.int/Documents/Handbook\\_non\\_discri\\_law\\_SQI.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/Handbook_non_discri_law_SQI.pdf), faqet 47 dhe 49

<sup>23</sup> “Karta Sociale Europiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr.8960, datë 24.10.2002.

<sup>24</sup> Referuar neni 3, pika 8,e LMD-së.

Adresa: Rruga e Durrësit, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al), web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

Mbështetur në nenin 1, nenin 3, pika 8, nenin 7, pika 1, nenet 12-13, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pika 4, gërma dh), si dhe pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e diskriminimit të F. B nga ana e Spitalit Universitar të Traumës Tiranë (SUT), për shkak të denoncimeve të tij mediatike, në cilësinë e z/v presidentit të Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë.
2. SUT, të marrë masat për ndreqjen e pasojave, duke rikthyer F. B në punë, në detyrën e mëparshme si Infermier i Urgjencës së Tiranës.
3. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dëgjimi për këtë vendim, SUT, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e tij.
4. Në referim të nenit 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2011, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, moszbatimi i këtij Vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dëgjimi.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

Fusha: Punësim

Shkaku: Përkatësia në një grup të veçantë, çdo shkak tjetër